



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 33
Prishtinë, më 22 shtator 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 22 DHE 23 SHATATOR 2011**

Mbledhjen e drejtoi Jakup Krasniqi, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se janë të pranishëm 74 deputetë.

Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 29 dhe 31 gusht 2011,
4. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për minierat dhe mineralet,
5. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për financat e pushtetit lokal,
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin

2010,

7. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Buxhetin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të huajt,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zjarrfikje dhe shpëtim,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe të pasurisë së tyre,
14. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Legjislacion lidhur me emërimin e drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsionit,
15. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,
16. Shqyrtimi i Propozim- vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishikimin e Ankesave,

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Bekim Haxhiu, Glauk Konjufca, Afërdita Berisha-Shaqiri, Zenun Pajaziti, Liburn Aliu, Hashim Deshishku dhe Sali Asllanaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2011, ka vendosur që në fillim të mbledhjes së sotme, ministri i Punëve të Brendshme të paraqesë Informatë lidhur me situatën në veri të Kosovës.

Ministri Bajram Rexhepi shpjegoi planin operacional të 16 shtatorit të Policisë së Kosovës, në koordinim me forcat e KFOR-it dhe të EULX-it për implementimin e konkluzioneve të arritura ndërmjet delegacionit të Kosovës dhe atij të Serbisë, në Bruksel, më 2 shtator 2011, lidhur me vulat doganore, për t'i funksionalizuar pikat doganore 1 dhe 31.

Ky plan operacional, theksoi ministri Rexhepi, është realizuar në bashkëveprim të ngushtë me KFOR-in dhe me EULEX-in. Në pikat kufitare 1 - Jarinjë dhe 31, policët kufitarë e kanë komandantin e pikës nga Policia Kufitare dhe nga një polic kufitar, ndërsa në dogana rolin udhëheqës e ka një zyrtar i Doganës së Kosovës, ndërsa detyrat operacionale i kryejnë përfaqësuesit e EULEK-sit dhe sigurinë e plotë e bëjnë trupat e KFOR-it, në një perimetër që e garanton sigurinë e tyre.

Momentalisht në pikat 1 dhe 31 qarkullimi bëhet kryesisht për udhëtarë, nuk ka qarkullim të mallrave, edhe pse dihet se kjo më tepër është për shkak të pengesave, barrikadave që janë në pjesën veriore.

Transportin e kanë marrë përsipër EULEX-i, bashkë me KFOR-in dhe bartja e policëve kufitarë dhe doganierëve bëhet me helikopterë të EULEX-it ose të KFOR-it.

Pas funksionalizimit të pikave 1 dhe 31, grupet e caktuara kriminale, kontrabandistë, kryetarë të komunave ilegale, të cilët janë të lidhur bashkë edhe me krimin e organizuar, por edhe me një mbështetje të strukturave të caktuara nga Beogradi, kanë

rezistuar dhe kanë penguar zbatimin e këtij plani. Ata kanë ngritur barrikada nëpër rrugët që shpijnë drejt pikave doganore dhe po e pengojnë qarkullimin e lirë të njerëzve.

Gjendja e sigurisë është nën kontroll, menaxhuar nga KFOR-i, EULEX-i dhe Policia e Kosovës. Natyrisht që ka tensione, është pak fragjile, mirëpo fal angazhimit të gjithë këtyre aktorëve, nuk kemi pasur incidente ndëretnike, nuk ka pasur vrasje as plagosje. Qytetarët në atë pjesë të vendit janë peng i strukturave kriminale dhe të kontrabandistëve të ndryshëm, të cilët e mbajnë peng edhe komunitetin serb në veri, por edhe komunitetet tjera. Ne jemi duke biseduar me KFOR-in dhe EULEX-in për të gjetur formën e heqjes së këtyre barrikadave, sepse qytetarët e Kosovës kanë nevojë për lëvizje të lirë, për shërbime shëndetësore, për shkollë, për furnizim me gjëra elementare, për përgatitje për sezonin dimëror dhe shumë të tjera.

Përgjegjësit e sektorit të sigurisë e kanë nën kontroll situatën e sigurisë dhe janë të gatshëm për të reaguar për çdo situatë dhe për të krijuar një mjedis të sigurt për të gjithë qytetarët që jetojnë në atë pjesë të Kosovës.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Time Kadrijaj, parashtroi pyetje për ministrin, Ferid Agani, në lidhje me databazën e të dhënave për numrin e pacientëve që kanë aplikuar në Ministrinë e Shëndetësisë për sigurimin e citostatikëve.

Ministri Ferid Agani, iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Safete Hadërgjonaj, parashtroi pyetje për ministrin, Mahir Yagcilar, në lidhje me fazën e hartimit të Projektligjit për pagat e zyrtarëve të lartë publik.

Ministri Yagcilar, iu përgjigj pyetjes së deputetes Safete Hadërgjonaj.

Deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri, parashtroi pyetje për ministrin Blerand Stavileci, në lidhje me veprimet e Ministrisë që ai drejton, për krijimin e kushteve më të mira për vendbanimet që shtrihen në pjesët kodrinore-malore në vend.

Ministri Blerand Stavileci, iu përgjigj pyetjes së deputetes Afërdita Berisha-Shaqiri.

Deputetja Albulena Haxhiu, parashtroi pyetje për ministren Vlora Çitaku, në lidhje me atë se ku gjenden pronat për të cilat flitet në Planin e veprimit 2011 për implementimin e partneritetit evropian në Kosovë.

Ministrja Vlora Çitaku, iu përgjigj pyetjes së deputetes Albulena Haxhiu.

Deputeti Glauk Konjufca, parashtroi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi, në lidhje me atë se çfarë masa të sigurisë janë marrë për afër 4000 banorët shqiptarë në veri të Kosovës.

Ministri Rexhepi, iu përgjigj pyetjes së deputetit Konjufca.

Deputeti Liburn Aliu, parashtroi pyetje për ministrin, Bajram Rexhepi, në lidhje me atë se cilat masa do t'i ndërmarrë Ministria e Brendshme për ta shtrirë sovranitetin në veri të vendit.

Ministri Rexhepi, iu përgjigj pyetjes së deputetit Aliu.

Deputetja Hykmete Bajrami, parashtroi pyetje për ministrin, Ferid Agani, në lidhje me mjetet për pagesat e kujdestarive në sektorin e shëndetësisë.

Ministri Ferid Agani, nuk ishte prezent në sallë.

Deputetja Hykmete Bajrami, parashtroi pyetje për ministrin, Nenad Rashiç, në lidhje me çështjet e pensioneve në Kosovë.

Ministri Rashiç, iu përgjigj pyetjes së deputetes Hykmete Bajrami.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 29 e 31 gusht 2011

Kuvendi miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve plenare të datës 29 dhe 31 gusht 2011.

4. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për minierat dhe mineralet

Deputeti, Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se komisioni ka monitoruar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Më tutje, deputeti Zenun Pajaziti u fokusua në rekomandimet të cilat i ka bërë Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si dhe në sfidat në të cilat hasur në praktikë zbatimin e tij.

Në fund, ai kërkoi miratimin e këtij raporti bashkë me rekomandimet e komisionit funksional.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, bashkë me rekomandimet e Komisionit funksional.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Hashim Deshishku, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Burim Ramadani, në emër të koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, dhe deputeti Shaip Muja, si dhe ministri Besim Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, bashkë me rekomandimet e Komisionit funksional.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 71,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Raporti i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për minierat dhe mineralet nr. 03/L-163, me rekomandimet e Komisionit funksional.

5. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për financat e pushtetit lokal

Deputetja Safete Hadërgjonaj, tha se Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa, në planin e punës për këtë vit ka paraparë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Në vazhdim, ajo tha se mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal, komisioni të cilin ajo e drejton, e ka bërë në dy nivele, në atë lokal dhe qendror.

Më tutje, deputetja Safete Hadërgjonaj u fokusua në rekomandimet të cilat i ka bërë Komisioni për Buxhet dhe Financa, si dhe në efektet që do të dalin nga këto rekomandime.

Në fund, ajo kërkoi miratimin e këtij raporti bashkë me rekomandimet e komisionit funksional.

Kryesuesi, Sabri Hamiti, hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal, bashkë me rekomandimet e komisionit funksional.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sali Asllanaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Albana Fetoshi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të koalicionit Kosova e Re, Muhamet Mustafa, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Jelena Bontiq, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal, bashkë me rekomandimet e komisionit funksional.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 63,
Kundër----- 3,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Raporti i Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr. 03/L-049, me rekomandimet e komisionit funksional.

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2010

Deputetja Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa tha se kemi shqyrtuar raportin në fjalë dhe kemi rekomanduar miratimin e tij.

Në vazhdim, ajo paraqiti një pasqyrë të hollësishme për gjendjen e mjeteve të Trustit, duke potencoi mes tjerash se nga mjetet e Trustit, në Bankën Qendrore të Kosovës, mbi 30 milion € janë të padestinuara, ndërsa vetëm 7.5% e mjeteve të gjithmbarshme të këtij Trusti janë investuar në Kosovë.

Në fund, deputetja Safete Hadërgjonaj ftoi deputetët për miratim të Raportit vjetor të punës së Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2010.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të punës së Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Latif Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Florin Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Jelena Bontiç, dhe deputeti Niazi Idrizi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	57,
Kundër-----	11,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Raporti vjetor i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2010.

7. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me buxhetin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Deputetja Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa tha se kemi shqyrtuar propozim-buxhetin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për periudhën 23 qershor – 31 dhjetor 2011, dhe Kuvendit ia kemi paraqitur rekomandimet e komisionit funksional për miratim.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me buxhetin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Albana Fetoshi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të koalicionit Kosova e Re, Myzejane Selmani, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Jelena Bontiç, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me buxhetin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 66,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

V E N D I M

1. Kuvendi miratoi buxhetin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për periudhën 23 qershor - 31 dhjetor 2011, në shumën prej 189,786.04 euro, sipas linjave buxhetore të paraqitura në tabelën 1 dhe 2, si aneks të këtij rekomandimi.
2. Ministria e Financave, në pajtim me nenin 17.3 të Ligjit nr. 04/L-001 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, të bëjë ndarjen e mjeteve buxhetore, duke bërë shkurtime përkatëse në ndarjet tjera buxhetore në vlerën e njëjtë për buxhetin e rekomanduar për Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011.
3. Ministria e Financave të përfshijë Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si organizatë të veçantë buxhetore, me kodet e reja, brenda tabelave të buxhetit për vitin 2011.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Ministri Bajram Rexhepi, tha se nevoja e hartimit të këtij projektligji konsiston në mbulimin e fushës së funksionimit dhe kompetencave të Qeverisë dhe të ministrive, duke precizuar ndarjen e punëve dhe të raporteve mes tyre si institucione ekzekutive, dhe raporteve me organet e administratës dhe institucionet tjera të Republikës së Kosovës.

Ai sqaroi më tej se fushëveprimi i këtij projektligji ka të bëjë me organizimin dhe funksionimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, mënyrën e punës, procedurat e vendimmarrjes në Qeveri etj.

Në vazhdim, ministri Rexhepi u fokusua në parimet udhëheqëse në të cilat bazohet puna e Qeverisë, sipas këtij projektligji dhe përputhjen e tij me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe standardet e BE-së.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Idriz Vehapi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Xhevahire Izmaku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sadri Ferati, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar- Koalicioni Kosova e Re, Muhamet Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Jasmina Zhivkoviç, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, si dhe deputetët: Hydajet Hyseni, Sabri Hamiti, Teuta Haxhiu dhe Haki Demolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 61,
Kundër----- 7,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregullore dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të huajt

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për të huajt.

Ministri **Bajram Rexhepi**, tha se nxjerrja e këtij Projektligji bazohet në Strategjinë legislative të Qeverisë së Kosovës për vitin 2011.

Në vazhdim, tha se ky projektligj adreson çështjet që kanë të bëjnë me të huajt që nga hyrja, lëvizja, si dhe qëndrimi i tyre në Republikën e Kosovës.

Ai sqaroi më tej se dispozitat e këtij Projektligji janë të zbatueshme për të huajt, për aq sa statusi i tyre nuk është i rregulluar me dispozita të tjera ligjore apo me marrëveshje ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Kosovës.

Ministri Rexhepi më tej theksoi se Ligji në fuqi nuk i rregullon masat ndëshkimore për të huajt, përderisa Projektligji për të cilin po diskutojmë i ka paraparë këto masa.

Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për të huajt. Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputeti Ahmet Isufi, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Fatmir Xhelili, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Anton Quni, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Gëzim Kelmendi, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Milivoje Stojanoviq, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 61,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për të huajt.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore

Zëvendëskryeministri **Bujar Bukoshi**, tha se ky Projektligj përcakton statusin, detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Kosovës për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore, si dhe hartimin dhe zbatimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore.

Ai më tej tha se ky Projektligj është në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me legjislacionin e BE-së nga kjo fushë dhe bën pjesë në grupin e Projektligjeve që janë pjesë e Raportit të progresit për Kosovën të Komisionit Evropian.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Nait Hasani, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Niazi Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sali Morina, në emër të grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Sevdije Lama, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Goran

Marinković, si dhe deputetja Teuta Sahatqija, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 42,
Kundër----- 17,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera.

Pasi që nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim, kryetari në vazhdim hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 69,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zjarrfikje dhe shpëtim

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për zjarrfikje dhe shpëtim.

Raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, e arsyetoi raportuesi i këtij komisioni, deputeti Fatmir Xhelili.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Xhelili, kryetari hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	70,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për zjarrfikje dhe shpëtim.

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe të pasurisë së tyre

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe të pasurisë së tyre.

Raportin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti Zenun Pajaziti.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Pajaziti, kryetari hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26 dhe 27.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Albulena Haxhiu, Teuta Sahatqija, Zenun Pajaziti, Ardian Gjini dhe Muhamet Mustafa. Këto diskutime janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	51,
Kundër-----	16,
Abstenime-----	10.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe të pasurisë së tyre.

Në vazhdim, Kryetari, propozoi që punimet e mbledhjes plenare për ditën e sotme të përfundojnë pas shqyrtimit të pikës nr. 13 të rendit të ditës, për të vazhduar ditën e nesërme me datën 23 shtator 2011 në orën 10:00.

Kuvendi miratoi propozimin e kryetarit.

E premte, 23 shtator 2011, ora 10:00

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 22 shtator 2011

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri HAMITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare, të filluar me datën 22 shtator 2011. Ai tha se në radhë është pika e 14-të e rendit të ditës:

14. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion lidhur me emërimin e drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsionit

Deputeti **Arben Gashi**, në emër të Komisionit për Legjislacion paraqiti arsyetimin e Rekomandimit lidhur me emërimin e drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsionit.

Ai tha se të dy kandidatët e intervistuar dhe të propozuar nga Komisionit për Legjislacion, Bashkim Zeqiri dhe Hasan Preteni, i plotësojnë kriteret formalo-juridike të parapara në Ligjin për Agjencinë kundër Korrupsionit, për t'u zgjedhur drejtor i saj.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin e përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën e drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsionit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Behar Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Kymete Bajraktari, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Jeton Svirca, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Jasmina Zhivkoviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Duda Balje, që janë dhënë në transkript.

Kryetari në vazhdim tha se pasi që janë të propozuar dy kandidat për pozitën e drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsionit, ndërsa sipas nenit 8.5 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit, Kuvendi me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të votave zgjedh njërin prej kandidatëve të propozuar, atëherë për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një Komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të administratës dhe ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtarë për Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. GP PDK - Halit Krasniqi,
2. GP LDK - Imri Ahmeti,
3. GP “Vetëvendosje” – Albulena Haxhiu,
4. GP AAK - Kimete Bajraktari,
5. GP Koalicioni Kosova e Re – Jeton Svirca,
6. GP SLS – Jasmina Zhivkoviq,
7. GP “6+” - Duda Balje.

Kuvendi miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në vazhdim, kryetari ftoi deputetët, një nga një, për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, Raportin e paraqiti deputeti, Halit Krasniqi .

Ai konstatoi se në votim morën pjesë 94 deputetë dhe rezultati i votimit është, si në vijim:

Për Bashkim Zeqirin, votuan 30 deputetë.

Për Hasan Pretenin, votuan 54 deputetë.

Të pavlefshme ishin 10 fletëvotime.

Pastaj, Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

1. Hasan PRETENI, emërohet drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit.
2. Mandati i të emëruarit nga pika nr. 1. e këtij vendimi zgjat pesë (5) vjet.

15. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti tha se komision ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Pasi nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për fjalë, **kryetari** hodhi në votim emërimin e z. Enver Halimi, anëtar të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 44,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 12.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

1. Enver HALIMI, emërohet anëtar në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.
2. Mandati i anëtarit nga pika nr. 1. e këtij vendimi është pesë (5) vjet.

16. Shqyrtimi i Propozim- vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishikimin e Ankesave

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja **Safete Hadërgjonaj** tha se komisioni ka shqyrtuar Propozim- vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishikimin e Ankesave dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi edhe deputetja, Hykmete Bajrami, diskutimi i plotë i së cilës është dhënë në transkript.

Pasi nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për fjalë, **kryetari** hodhi në votim emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishikimin e Ankesave, si në vijim: Skender Kolgeci, kryesues, ndërsa Faruk Prebreza, Loreta Peci, Agron Kajtazi, Shukri Hoxha, Vlora Zhuzhi, Abdullah Haxhiu dhe Hyda Hajrullah Dallku, anëtarë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 40,
Kundër----- 33,
Abstenime----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

I. Kuvendi emëroi kryesuesin dhe anëtarët në Bordin e Pavarur për Rishikimin e Ankesave, me mandat dy (2) vjeçar, si në vijim:

1. Skender Kolgeci, kryesues
2. Faruk Prebreza, anëtar
3. Loreta Peci, anëtare
4. Agron Kajtazi, anëtar
5. Shukri Hoxha, anëtar
6. Vlora Zhuzhi, anëtare
7. Abdullah Haxhiu, anëtar
8. Hyda Hajrullah Dallku, anëtare.

II. Mandati i të emëruarve nga pika nr.I. e këtij Vendimi zgjat dy (2) vjet.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 11:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.